



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjeto Më/Dana 05.07.2024			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vredmose
02-035/02	-	-	942



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Vitina

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) nr.28/2008, lidhur me nenin 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore që ka me datë 05.07.2024, merrë këtë:

## V E N D I M

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 61,052.30 € PËR FINANCIMIN E PROJEKTËVE TË INVESTIMEVE KAPITALE

- I. Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë, ndan mjetet financiare në shumë prej 61.052,30€ (Gjashtëdhjetë e Një Mijë e Pesëdhjetë e Dy presje Tridhjetë Euro) për financimin e projekteve të investimeve kapitale.
- II. Mjetet nga pika 1 i këtij vendimi merren nga participimi i projekteve me donatorë, kategoria e investimeve kapitale 2024, kodi i projektit 90552.
- III. Këto mjete barten për financimin e projekteve si ;
  - a). Bashkëfinancim me grantin e Përformancës në shumën prej 11,550.50 Euro për financimin e projektit për Rivitalizimin e rrugës "Hoxhë Jonuzi" dhe "Muhamet Muharremi".
  - b) Bashkëfinancim me grantin e përformancës në shumën prej 30,000.00 Euro për projektin, rrugullimin e rrugës dhe trotuarit me kalldërmë rreth lumit Morava.
  - c). Bashkëfinancim me Ministrin e zhvillimit Rajonal në shumën prej 19,501.80 Euro për financimin e projektit për rrugullimin e Inkubatorit të biznesit.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi i dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit
2. Drejtorisë për Financa, Ekonomi...
3. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti

